

Gratë, me status të avancuar në punësim e planifikim buxheti



Ibadete Hyseni, zyrtare komunale e barazisë gjinore, ka thënë se kjo rregullore do të jetë një bazë e mirë për zbatimin e politikave që çojnë drejt avancimit të pozitës së gruas si në aspektin e punësimit, ashtu edhe në arsimimin e saj

Ibrahim Sefedini

VITI, 17 MAJ – Komuna e Vitisë është bërë me rregullore të re të barazisë gjinore. Ajo parasheh masa ligjore për avancimin e pozitës së femrës në shoqëri. Rregullorja, e cila është miratuar nga Kuvendi Komunal, ka si qëllim që femrave t'u sigurohet mundësia më e madhe në aspektin e punësimit dhe pjesëmarrjen aktive në planifikimin e buxhetit komunal.

Ibadete Hyseni, zyrtare komunale për barazi gjinore, ka thënë se kjo rregullore do të jetë një bazë e mirë për zbatimin e politikave që çojnë drejt avancimit të pozitës së gruas, si në aspektin e punësimit, ashtu edhe në arsimimin e saj, në mirëqenjen sociale dhe në zbatimin e projekteve të Komunës, ku përfituese do të janë gratë. “Rregullorja parasheh masa afirmative në aspektin e punësimit në disa sektorë të Administratës komunale, ku gjendja është më e rëndë në aspektin e punësimit, pasi, sipas Rregullores për barazi gjinore, në konkurset për punësim në administratë, femrat do të kenë përparrësi punësimi”, ka thënë Hyseni. Ajo ka

theksuar se krahas shumë çështjeve të tjera që trajton Rregullorja e barazisë gjinore, në këtë dokument të Komunës trajtohet edhe buxhetimi sensitiv, ku në procesin e planifikimit të buxhetit Komuna është e obliguar të marrë parasysh kërkeshat që vijnë nga gratë për projekte të ndryshme si në infrastrukturë, ashtu edhe në fusha të tjera. “Buxhetimi i ndjeshëm gjinor është një komponentë e rëndësishme për Komunën në procesin e planifikimit të buxhetit dhe në zbatimin e kësaj komponente ndihmesë të madhe është duke na dhënë projektin i Qeverisë zvicerane LOGOS, dhe në saje të kësaj mbështetjeje pos që buxhetimi sensitiv ka hyrë si pjesë e rregullores komunale, që tashti janë identifikuar projektet, të cilat janë në interes të avancimit të pozitës së femrës në komunë e të cilat duhet të merren parasysh gjatë rishikimit të buxhetit të këtij viti dhe planifikimit të buxhetit për mot”, ka thënë Hyseni. Ajo është shprehur ndërkaq se në bazë të pyetësorëve me të cilët kanë punuar shërbimet e ndryshme të Komunës, ka dalë se hapja e një çerdheje përfshirë, hapja e para-

le leve për edukim parashkollar nëpër disa lokalitete, subvencionë i transportit të nxënësve që u takojnë familjeve të evidencuara si raste sociale, aktivitetet që kanë të bëjnë me ngritjen e shkallës së informimit të grave për Ligjin e barazisë gjinore dhe priorititet që kanë të bëjnë me ndërtimin e sistemeve të fshatra, janë vetëm disa nga prioritjet, të cilat parashihen në kuadër të buxhetimit të ndjeshëm gjinor. Ndërsa Luljata Vuniqi, konsulente profesionale e barazisë gjinore në projektin LOGOS, ka thënë se drejtoretë komunale në procesin e planifikimit të buxhetit duhet të angazhohen më tepër që të propozojnë projekte ku përfitues do të janë edhe gratë. “LOGOS pos që me ngritje kapacitetesh të zyrtarëve komunale për identifikim të nevojave dhe planifikim të buxhetit të ndjeshëm gjinor është duke ndihmuar Komunën që edhe nëpërmjet statistikave të ndryshme të identifikojë projektet që i plotësojnë nevojat e përgjithshme të komunitetit”, ka thënë Vuniqi.

©KOHA Ditore